# HEPATIT A - EPATITE A

Hepatiti A eshte nje semundje shume ngjitese qe i intereson melcise; eshte e shkaktuar nga nje mikroorganizem i quajtur virus i Hepatitit A. ne rastet me te shpeshta ngjitja ndodh duke ngrene ushqime ose duke pire uje te ndotur nga virusi, por mund te interesoj edhe perberesve te nje komuniteti, per shembull nje familje, nje shkolle, kur midis tyre gjindet nje person i semure .
Ne te ashtuquajturit **vendet ne rruge te zhvillimit semundja eshhte shume e perhapur** dhe prek perghithesisht femijet kurse ne vendet perendimore semundja eshte e rralle dhe personat e interesuar jane te rritur ose te rinjt te rritur.

SI SHFAQET SEMUNDJA
Pas nje periudh kohe te ndryshueshme nga 15 deri ne 50 dite, qe nga momenti qe ka ndodhur ngjitja, shfaqen simptomet tipike te semundjes qe jane: lodhje, humbja e oreksit, ikter (ngjyrosje e verdh e mukozave), ngjyrosje e erret e urines dhe ngjyrosje e hapur e jashteqitjes, temperature.
Ajo qe sapo u pershkrua eshte nje tablo tipike e hepatitit A, por kjo semundje mund te paraqitet ne menyra te ndryshme te cilat mund te jene o forma te lehta pa simptome te dukshme (gje qe shfaqet shpesh ne femijet), ose raste te ralla ku melcia eshte e prekur ne menyre te rend.
Hepatiti A zakonisht sherohet, nuk behet kronik kurr dhe jep nje imunitet qe mundesisht zgjat per te gjith jeten (personi nuk semuret nje here te dyte).
Personat e infektuar nga hepatiti A, si ne formen e lehte po ashtu edhe ne te renden, eliminojne gjate javeve virusin nepermjet jashteqitjes dhe prandaj mund te infektojne edhe persona te tjere.

CFARE DUHET TE BEHET PER TE PARANDALUAR HEPATITIN
Parandalimi i hepatitit A bazohet mbi adoptimin e perpikte te sjelljeve korrekte ne rrethin ushqimor dhe higjenik dhe ne vaksinimin.

a) sjelljet korrekte ne rrethin ushqimor dhe higjenik duhen te rispektohen gjithmone kur jeni ne udhetim ne zonat me rrezik te madh sepse mund t'ju mbrojne edhe nga semundjet e tjera infektive qe transmetohen ne menyre te ngjashme, si temperatura tifoide, kolera, forma te ndryshme dizenterie, etj.

Perbehen ne:

- perdorim i ushqimeve te sigurta (te gjith ushqimet te piqen mire dhe te hahen menjehere mbas pjekjes, djathi i staxhionuar, perimet e lara me kujdes ne uje te pijshem, qumeshti i pasterizuar, frutat e lara mire dhe te qerosura);
- te pihet uje sigurisht i pijshem; ne qofte se nuk eshte ne dispozicion, te zihet uji ose ne alternative te dizinfektohet me prudukt me klor ose te pordorni produkte ne tregti qe jane ne shitje ne kontejner te mbyllur me vule;
- merrni ushqime nga shites qe japin garanzi te mjaftueshme higjenike dhe sigurimi per prodhimet e tyre.

- te lahen gjithmone duart perpara se te pergatiten ose te konsumohen ushqime.

Vaksinimi i posaçem kunder hepatitit A eshte e rekomanduar personave qe do te perballojne nje udhetim ne zonat me rrezik dhe mbi te gjitha femijeve qe perballojne kete udhetim per here te pare. Vaksinimi i femijeve behet pa pagese deri ne mbushjen e vitit te 6-te te jetes.
**Ne qofte se ke planifikuar te perballosh nje udhetim ne vendin tend te lindjes, ne menyre te veçante ne qofte se me ty nisen edhe femije, drejtohu Sherbimit te Higjenes Publike qe keni me afer te pakten nje muaj para nisjes.**
Do te keni informacione te tjera dhe do te vleresohet mundesija e berjes se vaksines kunder hepatitit A.

I azhurnuar ne Qeshor 2003 / Aggiornato al Giugno 2003

I perkthyer nga Kooperativa INTEGRA / Tradotto da Cooperativa INTEGRA

Me kontibutin e Provinces se Modena / Con il contributo della Provincia di Modena

Per te ditur me teper drejtohuni ne:
Per saperne di più rivolgersi a: